



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:003822

Datë: 06.10.2022

Numri i dokumentit: 03500173

CN.nr.1/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje me gjyqtaren Elvira Emini, me bashkëpunëtoren profesionale Gentiana Dakaj, në procedurën e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj, duke vendosur në lidhje me kërkesën e propozuesit V. Rr. nga L., të cilin me autorizim e përfaqëson Qëndrim Reqica av. nga Lipjani, dhe S. L., jashtë seancës me dt. 16.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET I TËRHEQUR** propozimi i propozuesit V. Rr. nga L., me objekt të çështjes njohja e vendimit të huaj, në këtë çështje juridike jokontestimore.

A r s y e t i m

Propozuesi V. Rr. nga L., pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim për njohjen e aktgjykimit të gjykatës së huaj.

Gjykata sipas aktvendimit të datës 10.08.2022 e ka obliguar propozuesin që brenda afatit prej 3 ditësh të bëjë plotësimin e vendimit dhe të rregulloj propozimin duke i' a bashkangjitur një kopje me vulë origjinale të aktgjykimit me klauzolë të formës së prerë për njohjen e të cilit e kërkon si dhe të përkthyer tek përkthyesi i licencuar gjyqësor, si dhe çertifikatën e martesës në origjial të regjistruar në Kosovë, dhe nëse nuk e plotëson brenda afatit të caktuar nga ana e gjykatës, propozimi do të konsiderohet i tërhequr.

Gjykata vlerëson se propozuesi ka qenë i njoftuar në bazë të aktvendimit të marrë të dt.10.08.2022, konform nenit 102.1 të LPK-së, dhe meqenëse i njëjti brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e ka plotësuar dhe rregulluar propozimin, andaj në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata parashtrësën-propozimin e propozuesit e konsideroi si të tërhequr.

Gjyqtarja e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 102.3 dhe 387 pika s të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm

CN.nr.1/22 dt.16.09.2022

G J Y Q T A R J A

Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.